

VENDIM
Nr. 177, datë 23.8.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 55, DATË 22.2.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ARIS ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘GURI I ZI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC ‘DAZNJANË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, DHE HEC ‘SHËLLI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/4 prot., datë 19.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Aris Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Guri i Zi’, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC ‘Daznjanë’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC ‘Shëlli’, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 22.2.2021, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi”, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë”, me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli”, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë”, nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi”, dhe nr. 101 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Shëlli”, shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 16.7.2021), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

- Me shkresën nr. 399/1 prot., datë 22.7.2021, ERE ka rikujtuar shoqërinë, në lidhje me detyrimin e plotësimit, brenda afatit, të kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit të sipërcituar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 399/2 prot., datë 13.8.2021, shoqëria ka depozituar kontratat e rinovuara me Bashkinë Mat, përkatësisht për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor në pronësi/administrim të kësaj bashkie, për ndërtimin e HEC “Daznjanë”, “Guri i Zi” dhe “Shëlli”.

- Sa konstatohet nga përmbajtja e këtyre kontratave, rezulton se afati i qirasë përfundon më 15.7.2022, ndaj, pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.1.2021, duhet të ndryshohet, duke i lënë kusht shoqërisë, që në përfundim të këtij afati, t’i depozitojë ato, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 (një) muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.2.2021, ndryshon si vijon:

“3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 15.7.2022), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë ato në ERE, me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 (një) muaj nga nënshkrimi i rinovimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti